



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.279/2025

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi kryesues, Hajriz Hoti, dhe Violeta Husaj Rugova anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 03.02.2025, merr këtë :

### VE N D I M

**REFUZOHET E PA BAZUAR** ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, Anr.279/2025 datë 31.01.2025, parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

### A r s y e t i m

Me datë 31.01.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër Anr.279/2025 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në të cilën pretendohet se më 31 janar 2025, në rrjetin social në facebook, kanë vërejtur një postim të kandidatit për deputet nga subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, Avdullah Hoti, me tekstin i cili përmban gjuhë ofenduese, fyese dhe urrejtëse, e cila bie në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë.

Më tej në ankesë theksohet se në rrjetin social Facebook, shihet postimi "Nuk mund të mbaj leksione një ministër që nuk e di si krijohet buxheti. Ai nuk e di as ku po e shpenzon atë buxhet. Ka menaxhuar afër 12 miliardë euro dhe nuk është në gjendje të numërojë as 3 projekte të kryera për 4 vite qeverisje. Kaq për një diletant sikur ministri Murati.

PROVË: Postimi në rrjetin social Facebook  
<https://www.faceb00k.com/100044325704635/posts/1158767885610724/?mibextid=WC7FN>  
e.

Subjekti politik LDK brenda afatit të paraparë ligjor ushtron përgjigje në ankesën e parashtruesit të ankesës LVV, në të cilën theksohet se sa i përket rastit të ish-kryeministrit Hoti, të njëjtën e kundërshtojnë në tërësi për shkak të përdorimit të termit "diletant".

Më tej në përgjigje theksojnë se ky term është përdorur në kuadër të një analize të ligjshme, dhe të justifikueshme për të përshkruar veprime ose vendime që ishin të pasigurta, të papërgatitura, ose që mungonin në profesionalizëm. Sipas tyre fjala diletant nuk është fyese as denigruese dhe në fjalorin e gjuhës shqipe determinohet qartë se fjala "diletant" ka kuptimin diletant, -i emër i giinisë mashkullore; numri shumës; -ë(t)l. amator. 2. me kuptim keqësues; ai që merret me veprimtari në fushën e shkencës, të artit etj. pa pasur përgatitjen e nevojshme: ra në duar diletanti. Në postimin e ish-kryeministrit Hoti në rrjetin e tij social facebook. nuk ka gjuhe provokuese, nxitese apo urrejtese, sepse keto perkufizime nuk mund t' i jap ankuesi, keto mbeten ne kuadrin e pretendimeve derisa vendoset ndryshe.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3, dhe nenit 118 par.1 të LZP-së, konstatoi se:

#### **-Ankesa është e pabazuar.**

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës të ofruara si provë materiale, dhe vlerësimit të përgjigjes në ankesë të subjektit politik LDK ka gjetur se veprimet e kandidatit për deputet, Avdullah Hoti, në postimin e bërë me datë 31.01.2025 në rrjetin social facebook, në të cilin postim thuhet se: *"Nuk mund të mbaj leksione një ministër që nuk e di si krijohet buxheti. Ai nuk e di as ku po e shpenzon atë buxhet. Ka menaxhuar afër 12 miliardë euro dhe nuk është në gjendje të numërojë as 3 projekte të kryera për 4 vite qeverisje"*. Paneli vlerëson se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me gjuhë denigruese, dhe urrejtëse në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore.

Diskursi i tillë i përdorur nga kandidati i subjektit politik LDK, nuk mund të konsiderohet se përdorimi i një gjuhe të tillë, mund të nxit ose provokon, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, po ashtu nuk është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, në të cilin në nen në mënyrë decidive thuhet se: *"Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërisë si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë"*.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *"vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartpërmendura ligjore, dhe si të tillë të njëjtat i refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke u bazuar edhe në nenin 117 paragrafi 3, dhe nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**

Anr.279/2025 datë 03.02.2025

**Kryesues i Panelit,  
Bujar Muzaqi**



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.